



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.06.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”.

2. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar”.

3. Shqyrtim nen për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Eljo Hyskaj, Luan Duzha, Lefter Maliqi, Anduel Xhindi, Myslim Murrizi, Antoneta Dhima, Ylli Shehu, Edmond Rrushi, Elona Hoxha, Xhemal Qefalia, Spartak Braho, Adnor Shameti dhe Arben Elezi.

Mungojnë:

Elena Xhina, Paulin Sterkaj, Luan Harusha dhe Alban Zeneli.

Të ftuar:

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Artur Kala – Kryeadministrator i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Elvis Koçi – Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Parandalimit dhe Pastrimit të Parave

Agim Muslia – Drejtor i Drejtorisë së Përputhshmërisë në Drejtorinë e Përgjithshme të
Parandalimit dhe Pastrimit të Parave

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Fillojmë mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare, meqenëse kuorumi është i plotë. Në fakt, sot kemi miratimin nen për nen dhe në tërësi, duke mbyllur kështu paketën e tri ligjeve, që janë propozuar lidhur me rekomandimet e MONEYVAL-it.

Do të doja ta fillonim mbledhjen, në fakt, me shqyrtimin nen për nen të projektligjit, që ne e kemi shqyrtuar edhe në parim “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”.

Për të tria projektligjet të ftuar në komision kemi: zotin Elton Haxhi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, zotin Artur Kala, kryeadministrator i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, zotin Elvis Koçi, drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, si dhe zotin Agim Muslia, drejtor i Përputhshmërisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave.

Gjykoj që mund të procedojmë normalisht me mbledhjen.

Për lehtësinë e punës së secilit, stafi i komisionit u ka shpërndarë deputetëve tabelën e ndryshimeve të propozuara për secilin prej projektligjeve.

Ju lutem, të punojmë me tabelën, që përmban ndryshimet në ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, se iu referova ligjit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka ndryshuar edhe titulli i ligjit, ndaj isha në rregull.

Pra, kemi ligjin nr. 10192 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe projektligjin e propozuar (që e kemi për lehtësi të të parit të gjërave) “Për administrimin e pasurive të konfiskuara dhe të sekuestruara”.

Fillojmë me shqyrtimin e nenit 1 të projektligjit “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, që bën fjalë për objektin e ligjit, rregullat, procedurat dhe mënyrat që do të ndiqen nga agjencia përkatëse për menaxhimin e të gjitha pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, që lindin nga hetimi antimafia, si dhe nga sekuestrimet e kryera për shkak të zbatimit të pjesës, që ka Kodi i Procedurës Penale.

Ka vërejtje për nenin 1 “Objekti”? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 “Qëllimi”. Në fakt, nga komisioni ynë nuk ka asnjë vërejtje të depozituar dhe, njëkohësisht, asnjë koment qoftë nga komisionet e tjera parlamentare, pavarësisht se ne nuk jemi komision përgjegjës.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3 “Fusha e zbatimit të ligjit”. Pra, edhe një herë, bëhet fjalë se cili do të jetë organi që do të administrojë pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara me vendim gjykate, sipas përcaktimeve që përmban ligji për hetimin pasuror, antimafia, se cila do të jetë agjencia që do të menaxhojë pasuritë e bllokuara dhe të sekuestruara, sipas ligjit “Për masat kundër financimit të terrorizmit” dhe, njëkohësisht, të gjitha pasuritë e tjera...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më herët kemi folur me përfaqësuesin e agjencisë, i cili na tha që bëhet fjalë për të gjitha pasuritë ndaj të cilave është vendosur masa e sekuestros preventive. Kush ka vërejtje ose pyetje për nenin 3? Nuk ka.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4 “Përkufizimet”. Ka ndonjë ndërhyrje nga kolegët për përkufizimet e ligjit?

Ka pyetje ose vërejtje? Nuk ka pyetje. Nuk ka vërejtje.

Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 5, që bën fjalë për parimet e përgjithshme se si do të realizohet administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Natyrisht, do të ndiqen parime që janë të njohura, si: miradministrimi, efektiviteti, eficientia, ekonomikiteti, transparenca, ligjshmëria dhe shmangia e çdo keqpërdorimi ose abuzimi.

Kush është dakord me nenin 5? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu II, neni 6 “Organizimi dhe funksionimi”. Pra, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, kujtoj për kolegët, ekziston që prej vitit 2005, por është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe veprimtarinë e saj e bazonte në një akt nënligjor, siç është vendimi në fjalë. Ndërkohë, tashmë jemi përballë një risie, pasi e gjithë

veprimtaria e këtij organi do të bazohet në një ligj të tillë, që është asistuar edhe nga ekspertë të huaj italianë, për shkak se edhe ligji për hetimin pasuror, antimafia është një ligj me ekspertizë italiane. Natyrisht, është gjë shumë e mirë që eksperiencia është marrë edhe në vijim dhe është transpozuar në këtë projektligj.

Ka vërejtje për nenin 6? Nuk ka. Ka pyetje? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 6? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 7, ku përcaktohet buxheti i Agjencisë. Ky buxhet do të financohet nga buxheti i shtetit, nga të ardhurat që do të krijohen nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, të ardhurat e krijuara nga tjetërsimi i pasurive në fjalë, si dhe nga donacionet, dhuratat dhe burime të tjera të ligjshme, që mund t'i vijnë agjencisë.

Ka pyetje ose vërejtje për nenin 7, para se ta votojmë? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 7?

(Diskutime në sallë)

Ju lutem, kolegë, na ndiqni në votim!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 8, që bën fjalë për kompetencat dhe përgjegjësitë. Në fakt, nuk ka pasur vërejtje nga asnjë komision në raport me këtë nen, qoftë edhe për të ndihmuar kolegët. Ndaj, kush është dakord me nenin 8? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 9, që bën fjalë për të drejtat dhe detyrat e kryeadministratorit. Ka pyetje ose vërejtje lidhur me përmbajtjen e këtij neni, siç propozohet? Nuk ka.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10 “Administratori – koordinator”... Në fakt, këto nuk kanë të bëjnë shumë me thelbin e punës se sa me mënyrën e organizimit. Kush është dakord me nenin 10? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11 “Administratori i pasurisë së sekuestruar”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ju lutem, nëse ndonjëri prej jush ka diçka për të thënë për ndonjërin nga nenet, mund të ndërhyjë.

Kalojmë te neni 12, që bën fjalë për detyrat dhe të drejtat e administratorit të pasurisë së bllokuar dhe të sekuestruar me urdhër administrativ.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 13 “Administratori i pasurisë së konfiskuar”. Pra, ka disa administratorë ose, le ta themi ndryshe, ka disa emërtime administratorësh.

Kush është dakord me nenin 13? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14. Ky nen bën fjalë për ndalimet, që i vendosen administratorit të një pasurie të sekuestruar ose të konfiskuar. Sigurisht që ka disa detyrime ndaj këtyre administratorëve: nuk mund të marrin pjesë në gjykim, nuk mund të marrin kredi, nuk mund të marrin pjesë në procedurat e pajtimit, tjetërsimit dhe arbitrazhit. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15 “Raportimi”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu III, neni 16, që bën fjalë për administrimin e pasurive të sekuestruara, pra se si merren në dorëzim, nga gjykata kompetente dhe administrohen. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 16.

Neni 17 “Marrja në dorëzim e pasurisë së sekuestruar me urdhër administrativ”. Edhe nga titullimi i nenit duket qartë se bëhet fjalë për procedurë.

Kush është dakord me nenin 17? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet neni 17.

Kalojmë te neni 18 “Sigurimi i pasurisë”.

Pra, çdo pasuri e sekuestruar dhe e konfiskuar, që merret nën administrim nga agjencia, i nënshtrohet sigurimit, në rast se hyn tek ato objekte që mundet të sigurohen nga faktorë që mund të vënë në rrezik konsistencën e tyre.

Kush është dakord me nenin 18? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19 “Administrimi i pasurisë së paluajtshme”.

Kush është dakord me nenin 19? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20 “Administrimi i pasurisë së luajtshme”.

Kush është dakord me nenin 20? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21 “Kalimi i të drejtave reale për pasuritë e sekuestruara”.

Kush është dakord me nenin 21? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22 “Dorëzimi i pasurive në rastet e revokimit të masës së sekuestrimit”. Kuptohet që pasuria në vetvete apo kundërvlehtë, në rast se ajo hyn tek ato asete, që mund të prishen ose mund të humbasin vlerën gjatë kohës së qëndrimit të tyre si të sekuestruara dhe të konfiskuara, dorëzohet. Këtë gjë e kemi sqaruar edhe gjatë diskutimit në parim.

Kush është dakord me nenin 22? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu IV “Administrimi i pasurive të konfiskuara” për të dalluar sekuestrimin nga konfiskimi, sepse janë dy gjëra të ndryshme. Konfiskimi në të drejtën civile njihet edhe si një nga mënyrat e fitimit të pronësisë.

Neni 23 “Kalimi i pronës në favor të shtetit”.

A ka ndonjë vërejtje nga kolegët? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 23? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 24 “Komiteti Këshillimor Ndërinstitucional i Ekspertëve për Masat kundër Krimit të Organizuar”. Ne kemi thënë se është një komitet shumë i rëndësishëm, që, ndër të tjera, vendos edhe mënyrën se si do të ndahen të ardhurat e përfituara nga administrimi i sendeve të konfiskuara, se ku do të kalojë ato, një pjesë do të kalojnë në buxhetin e shtetit, një pjesë do të kalojnë në fondin për parandalimin e kriminalitetit.

Elona Gjebrea - A mund të bëj një pyetje?

Ermonela Felaj – Po, para se ta hedhim në votë nenin 24, zonja Gjebrea ka një pyetje.

Elona Gjebrea – Faleminderit!

Mua nuk më duket shumë fjalë shqip “destinimin e pasurive”. A ka ndonjë fjalë tjetër më shqip?

(Diskutime pa mikrofon.)

Artur Kala - Fjala “destinim” është përdoruar vazhdimisht në të gjithë procedurën që ka ndjekur agjencia, është edhe në ligjin antimafia, ndaj ne nuk donim që ta zëvendësonim, pra, meqenëse ishte edhe në të gjitha aktet e tjera, e lamë ashtu.

Ermonela Felaj – Megjithatë, ne mundemi që ta hedhim në votë edhe sugjerimin e zonjës Gjebrea për redaktorët, sepse kjo është puna e redaktorëve të projektit për ta zëvendësuar këtë fjalë me fjalën e duhur shqipe.

Në fakt, është detyrim që gjuha e ligjeve të jetë sa më e pastër dhe, natyrisht, duhet të jetë shqip.

Kush është dakord me nenin 24? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 25 “Destinimi dhe mënyra e përdorimit të pasurive të konfiskuara”. Besoj se edhe në këtë nen qëndron i njëjti sugjerim që bëri zonja Gjebrea.

Kush është dakord me nenin 25? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 26 “Përdorimi i mjeteve monetare të sendeve të konfiskuara”.

A ka pyetje nga kolegët për këtë nen?

Elona Gjebrea - Faleminderit, zonja kryetare!

Te neni 26 thuhet: “...nuk do të përdoren për dëmshpërblimin e viktimave të veprave penale të krimit të organizuar dhe trafikimit.” Unë doja të dija se për trafikimit e kujt bëhet fjalë? Pse duhet ndarë? Pse nuk futet te krimi i organizuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është neni 26, germa “a”: “Të konfiskuara, që nuk do të përdoren për administrimin e pasurive të tjera të konfiskuara, ose që nuk do të përdoren për dëmshpërblimin e viktimave të veprave penale të krimit të organizuar dhe trafikimit”. Unë mendoj se duhet ta përcaktojmë trafikimin e kujt bëhet fjalë, sepse janë edhe lëndët narkotike, për shembull, që futen te krimi i organizuar?

Zoti Kala , a do ta jepni ju përgjigjen?

Artur Kala - Trafikimi i qenieve njerëzore, sepse, normal, është objekt edhe i mbështetjes financiare edhe te ligji i antimafies, por, gjithsesi, mund të bëhet edhe një sqarim i mëtejshëm.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ermonela Felaj – Aty bëhet fjalë për krimin e trafikimit në përgjithësi.

(Diskutime pa mikrofon.)

Në rregull, në qoftë se bëhet fjalë vetëm për mjete monetare, që rrjedhin nga konfiskimet e ndodhura në rastin e kësaj vepre penale, do ta përcaktojmë duke thënë: “...trafikimi i qenieve njerëzore”.

A ka ndonjë vërejtje tjetër për nenin 26? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 26, me saktësimin e bërë nga zonja Gjebrea për të dyja germet “a” dhe “b”? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 27 “Tjetërsimi dhe dhënia në përdorim”.

A ka pyetje apo vërejte nga kolegët për këtë nen? Ky nen flet për rastet kur një pasuri e konfiskuar ose e sekuestruar do t’i kalohet një të treti dhe natyrisht do të shoqërohet me një dosje të plotë.

Kush është dakord me nenin 27? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 28 “Raportimi periodik në Këshillin e Ministrave”.

Unë kam një sugjerim për këtë nen dhe do të doja të dëgjoja qëndrimin e zotit Kala ose të zëvendësministrit të Financave. Ne pak a shumë iu qasëm kësaj gjëje edhe gjatë diskutimit në parim. Ne do të mendonim se do të ishte e nevojshme që një raportim ta kishte edhe në Komisionin e Sigurisë, meqenëse një pjesë e mirë e veprimtarisë suaj është e lidhur ngushtësisht me luftën kundër krimit dhe të dhënat, që bëjnë fjalë për shifrat lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin, janë gjithmonë pjesë e të dhënave në luftën kundër kriminalitetit. Besoj se ky raportim para këtij komisioni do ta bënte më transparente për parlamentin punën tuaj, sepse raportimi, që ju bëni në qeveri, është një raportim i kufizuar dhe i mbyllur për të cilin ne nuk marrim dijeni. Besoj se do të ishte mirë që ta vendosim këtë detyrim sot, megjithatë dua të dëgjoj mendimet tuaja dhe të kolegëve.

Artur Kala – E nderuar kryetare e komisionit, ne nuk kemi asnjë vërejtje që të raportojmë edhe te Komisioni i Sigurisë, sepse ne bëjmë raporte 3-mujore dhe 1-vjeçare të Komitetit të Ekspertëve për masat kundër krimit të organizuar për aktivitetin e agjencisë. Gjithashtu, kemi raportin e ministrit të Financave dhe të Këshillit të Ministrave që përcaktohen në ligj, por edhe që kanë qenë pjesë e praktikës së punës sonë. Absolutisht që nuk kemi asnjë vërejtje për të raportuar edhe te Komisioni i Sigurisë.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Kala!

Ne mund të ndjekim dy opsione: ose ta detyrojmë agjencinë që raportin periodik ta ketë në faqen e vet dhe të jetë publik për të gjithë, ose të shtojmë aty: “Krahas raportimit në Këshillin

e Ministrave, Agjencia raporton edhe në Komisionin e Sigurisë Kombëtare”. A mund të kemi ndonjë opinion tjetër për këtë pjesë?

Po, zonja Gjebrea, çfarë mendimi keni?

Elona Gjebrea – Jam dakord. Nuk kam asgjë tjetër.

Ermonela Felaj – Po, zoti Haxhi.

Elton Haxhi – Dakord, mund ta sjellim raportin vjetor. Nuk besoj se frekuenca ka nevojë të jetë 3-mujore, siç raportohet në strukturat e tjera që përmendi drejtori, por raportin vjetor mund ta sjellim në këtë komision dhe, nëse do të kërkohet edhe prezantim, jemi të hapur.

Ermonela Felaj – Propozimi është që në nenin 28 të ndryshohet titulli, që, natyrisht nuk do të jetë vetëm një raportim. Të vendosim titullin “Raportimi periodik” dhe pika e parë të jetë për raportimin që ju të jeni detyruar t’i bëni Këshillit të Ministrave nëpërmjet ministrit. Për pikën e dytë ne mund ta bëjmë formulim shumë shpejt, sa të mbarojmë miratimin nën për nen të këtij projekti, të jetë edhe në Komisionin parlamentar përgjegjës për Sigurinë.

Kush është dakord me propozimet e bëra për nenin 28? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu i pestë “Për të ardhurat dhe shpenzimet për administrimin e pasurive të sekuestruara”.

Kush është dakord me nenin 29? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 30 “Shpenzimet për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 31 “Përballimi i shpenzimeve të administrimit, që lindin nga administrimi i pasurive të sekuestruara”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë e kam nenin 31.

Kush është dakord për këtë nen, sepse, natyrisht, administrimi i një pasurie mund të sjellë edhe shpenzime? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 32 “Përballimi i shpenzimeve të administrimit, që lindin nga administrimi i pasurive të konfiskuara”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 33 që bën fjalë për regjistrim elektronik. Në fakt, kjo ishte edhe një risi, që drejtori na e shpjegoi gjatë diskutimit në parim. Kush është dakord me nenin 33 “Regjistri elektronik”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu i fundit i ligjit, që lidhet me dispozitat transitorë ose kalimtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A ka procedurë, apo jo?

Kush është dakord me nenin 34? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 35, që bën fjalë për detyrimin e Këshillit të Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore.

Kam një pyetje për zotin Kala dhe për zëvendësministrin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Iu drejtova zotit Kala, meqenëse janë ata drejtpërdrejt përfituesit e këtij projekti.

Koha 6 muaj, që kërkohet këtu, më duket shumë e gjatë. Çështjet e afateve të nxjerrjes së akteve nënligjore janë bërë vazhdimisht objekt diskutimi në komisionet e ndryshme parlamentare të Kuvendit. Ne na duhen këto projekte, sepse janë pjesë e vlerësimit për Shqipërinë nga komiteti MONEYVAL, por a mendoni se mund ta shkurtojmë kohën nga 6 muaj në 3 muaj?

Artur Kala – Ne do të përpiqemi t’i bëjmë më shpejt se 6 muaj, që të nxjerrim aktet nënligjore, por duke marrë parasysh që janë shumë akte nënligjore, është mirë të jetë afati 6-mujor. Më pas ne do të përpiqemi t’i mbyllim të gjitha aktet nënligjore për 3-4 muaj, sepse janë disa VKM dhe udhëzime që duhet ta plotësojnë këtë ligj.

Ermonela Felaj – Nëse unë nuk i numëroj gabim, nuk keni më shumë se 6 ose 7 akte nënligjore. A i bëni dot për 3 muaj, apo jo?

Po, zoti Haxhi.

Elton Haxhi – Shumica e ekipit që ka agjencia janë administratorë të pasurive dhe nuk ka një departament të mirëfilltë ligjor që merret me shkrimin e akteve. Sigurisht që ministria do të ndihmojë në këtë proces, por mendoj se pak fleksibilitet do të lehtësojë hartimin e akteve nënligjore. Megjithatë, është në gjykimin tuaj për 3 ose 6 muaj, por ne mendojmë se afati 6 muaj, siç e tha edhe drejtori, është vënë si një tavan maksimal dhe nuk ndikon në punën e agjencisë, pasi agjencia është në funksion, ka rregullore, VKM në bazat e së cilës funksionon për momentin, kështu që edhe perioda transitorë nuk do të ndikojë në punën e saj.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Dakord.

Besoj se mund të gjejmë mirëkuptim në fjalën tuaj për dy arsye:

E para, është e vërtetë se afati 6-mujor është tavani, nuk është afati dysHEME, le të themi.

E dyta, agjencia, në vetvete, ka 8 persona, në mos gaboj, dhe kërkon të ketë në dispozicion 19.

Gjykuar në këto dy pika, mendoj se ndoshta do t'ju duhet vërtet kohë për të përgatitur draftet e këtyre akteve.

Kush është dakord me nenin 35, siç është propozuar nga iniciuesi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 36 bën fjalë për disa shfuqizime kryesisht në ligjin antimafia. Kush është dakord me nenin 36? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 37 bën fjalë për hyrjen në fuqi. Nuk është propozuar afati i zakonshëm i hyrjes në fuqi, por është propozuar afati 30 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare. Kush është dakord me nenin 37? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në miratimin në tërësi të projektligjit “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”. Kush është dakord me këtë projektligj? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.06.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtim i Projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar”.

Marrin pjese:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Eljo Hysko, Luan Duzha, Lefter Maliqi, Anduel Xhindi, Myslim Murrizi, Antoneta Dhima, Ylli Shehu, Edmond Rrushi, Elona Hoxha, Xhemal Qefalia, Spartak Braho, Adnor Shameti dhe Arben Elezi.

Mungojnë:

Elena Xhina, Paulin Sterkaj, Luan Harusha dhe Alban Zeneli.

Të ftuar:

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë.

Artur Kala - Kryeadministrator i AAPSK-së

Elvis Koci - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Parandalimit dhe Pastrimit të Parave

Agim Muslia - Drejtor i Drejtorisë së Përputhshmërisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave

Ermonela Felaj - Kalojmë te projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar”.

Ky projektligj është më i shkurtër, me 12 nene, dhe e diskutuam në parim gjatë ditës së djeshme.

Para se të kalojmë në miratimin nen për nen, do të doja t’i jepja fjalën zotit Murrizi, sepse ka shtruar një pyetje dhe ramë dakord me përfaqësuesit që të kishim një përgjigje.

Në fillim, do të doja që dikush nga ju të marrë fjalën për pyetjen e zotit Murrizi. Nëse është e nevojshme që zoti Murrizi ta përsërisë pyetjen e tij, besoj se do të jetë i disponueshëm.

Faleminderit, zoti Murrizi!

Myslim Murrizi – Faleminderit!

Dje kam drejtuar një pyetje konkrete për ju, meqë bëhet fjalë për projektligjin e pastrimit të parave. Kam pyetur për dy vëllezërit indianë, të cilët kanë ardhur në Shqipëri dhe janë pajisur me pasaporta diplomatike, gjithashtu kanë marrë edhe statusin e Konsullit të Nderit, ndërkohë që në Indi akuzohen për pastrimin e 1 miliard eurove. Pyetja ka qenë: a keni ju informacion se si i kanë prurë këto para në Shqipëri këta dy indianë, të shpallur nga Presidenti i Republikës si “Konsull Nderi”, me trastë, thes apo me llogari bankare?

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Po, zoti Koçi.

Elvis Koçi – Faleminderit!

Ne dëshirojmë që përgjigjen e kësaj pyetje ta japim në një moment pa kamera dhe personat që do të jenë në sallë, të jenë të pajisur me certifikatë sigurie.

Ermonela Felaj – Dakord.

Gjykoj se është e mira të mos krijojmë pengesa, ta lëmë për në fund këtë çështje. Sigurisht, kolegët e rinj nuk kanë të gjithë certifikatë sigurie, ndaj duhet të mos jenë prezentë gjatë dhënies së përgjigjes, ndërkohë që pjesa tjetër e kolegëve ka certifikatë sigurie për t’i dhënë përgjigje pyetjes së zotit Murrizi.

Kalojmë te ligji. Edhe për këtë projektligj kemi një tabelë përkatëse, nëse do ta vinim të gjithë përpara do të ishte me e thjeshtë për ne të ndjekim çdo ndryshim që propozohet.

Për nenin 1 të projektligjit, te tabela, do të shihni që keni edhe propozimet e Komisionit të Ekonomisë. Këto i kemi dhënë thjesht për t’u orientuar me pyetjet, por jo se jemi ne komisioni që merr në shqyrtim propozimet e Komisionit të Ekonomisë, është Komisioni i Ligjeve.

Gjithsesi, për efekt të medies, propozimi që ka bërë Komisioni i Ekonomisë është ai për përdorimin korrekt të termave, pra themi “ministri përgjegjës për Financat” dhe jo “ministri i Financave”, thuhet “ministri përgjegjës për sigurinë” dhe jo “ministri i Brendshëm” e me radhë.

Këto janë propozimet e tyre, por e thashë edhe një herë që nuk na takon neve ta vendosim.

Për nenin 1, ashtu siç është propozuar nga qeveria, a ka vërejtje ose pyetje nga relatorët? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 2.

Ky nen ndryshon nenin 6 në nenin ekzistues, duke zgjeruar rrethin e pasurive dhe fondeve, ndaj të cilave mund të aplikohen masat përkatëse nga ana e Drejtorisë së Parandalimit dhe Pastrimit të Parave.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 3, i cili bën disa ndryshime në nenin 10 të ligjit ekzistues, ku bëhet fjalë për detyrimin për raportim. Ai që ndryshom është rrethi i personave që duhet të raportojnë dhe fakti që raportojnë menjëherë pa njoftim paraprak të personave të dyshuar. Besoj se kjo është një risi në punën e Drejtorisë së Parandalimit dhe Pastrimit të Parave dhe diçka që e bën edhe më eficiente veprimin e tyre dhe më në kohë.

Kush është dakord me nenin 3? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 4, i cili, në fakt, shton një nen në ligjin ekzistues pas nenit 10. Këtu bëhet fjalë që subjektet që kanë detyrimin për raportim, menjëherë pasi shpallet lista e personave terroristë ose financues të terrorizmit nga OKB-ja, janë të detyruar të zbatojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë bllokimin e çdo veprimi, ndërmjetësimi, transaksioni, transferte, shërbimi financiar, etj. Pra mund të themi që “menjëhershmeria” është kryefjala e të dyja neneve.

Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea - Nuk është objekt i punës sonë, por po e them gjithsesi.

Ky nen, sigurisht që sjell risi, por është shumë i gjatë dhe mund të ndahet shumë mirë në dy paragrafë pa e kushtëzuar procesin mund të jetë një paragraf dhe të vazhdojë me një lidhje me pjesën tjetër.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Është çështje e të shkruarit, por nuk besoj se është vërejtje e natyrës thelbësore, sepse këtu theksohet qartësisht, që asnjë nga subjektet e detyruara të kryejnë një veprim ndaj një pasurie, e cila është e orientuar për të financuar terrorizmin, duhet të bllokohet menjëherë.

Kush është dakord me nenin 4?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 5, i cili bën ndryshim në nenin 14, që është procedura e shpalljes, mbështetur në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Neni 5 ka lidhje në fakt me nenin 4. Te neni 5 thuhet: “...duke njoftuar njëkohësisht organet përgjegjëse të zbatimit të ligjit...”, te neni 4, pika 3 thuhet: “ndalohej njoftimi paraprak i personave”, por nuk thuhet nga kush. Mos duhet sqaruar kjo?

Ermonela Felaj – Jo, besoj se është e qartë, kur thuhet njoftim paraprak është fjala për persona të dyshuar, pra ata nuk njoftohen paraprakisht në momentin që do të bllokohet një pasuri e tyre, ose një fond që lidhet me ta. Pra, organet që duhet të bëjnë bllokimin, e bëjnë menjëherë dhe pa njoftim paraprak, kurse neni 5 ka lidhje me detyrimin që ka ministri i Jashtëm, si personi i parë që merr në dispozicion listën e personave të shpallur terroristë nga OKB-ja dhe, sapo e merr ka për detyrim të njoftojë të gjitha organet, që bien në fushën e veprimit të këtyre detyrimeve. Kështu që besoj se është e qartë.

Kush është dakord me nenin 5?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 6 të projektit, i cili ndryshon nenin 15 të ligjit aktual, që bën fjalë për procedurën e brendshme të shpalljes.

Kolegët mund të marrin kohë që ta shohin.

A ka ndonjë pyetje apo sugjerim? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 6?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 7, që bën fjalë për disa ndryshime në nenin 16 të ligjit aktual, konkretisht për bllokimin e përkohshëm. Nëse ministri i Financave e kishte deri sot në diskrecion vlerësimin e bllokimit paraprak dhe të përkohshëm të fondeve dhe pasurive të tjera, që dyshohen se vihen në dispozicion të akteve që kanë lidhje me terrorizmin, me ndryshimin e bërë propozohet që kjo nuk është me në diskrecionin e tij por e ka detyrim të urdhërojë pa njoftim paraprak bllokimin e përkohshëm të fondeve dhe pasurive të tjera dhe përpara nxjerrjes së vendimit nga ana e KM. Njëkohësisht ka një ndryshim tjetër, i cili zgjat afatin e bllokimit nga 30 në 45 ditë pune jo kalendarike.

Atëherë, kush është dakord me ndryshimet e propozuara?

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet neni 7.

Kalojmë te neni 8, i cili bën disa ndryshime në nenin 18 të ligjit aktual, që ka të bëjë me vendimin e Këshillit të Ministrave. Është vendimi që merr Këshilli i Ministrave për listën e personave të shpallur terroristë. Është bërë një ndryshim në këtë nen.

Elona Gjebrea – Kam një pyetje.

Ermonela Felaj – Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Te neni ekzistues thuhet: “Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme apo ministrit të Financave, vendos miratimin, ndryshimin ose revokimin e listës së personave të shpallur terroristë, për të cilët zbatohet masa kundër financimit të terrorizmit.”

Përse është përjashtuar Ministria e Punëve të Brendshme? Më saktë, a mund të futet (nuk është përjashtuar, se nuk ka qenë) edhe Ministria e Punëve të Brendshme? Mendoj se në lidhje me këtë çështje Ministria e Punëve të Jashtme patjetër që e merr informacionet nga Ministria e Punëve të Brendshme, por jo gjithmonë. Gjithsesi, mendoj që janë tri ministri përgjegjëse.

Ermonela Felaj – Kush do të përgjigjet, zoti Koçi apo zoti Haxhi?

Elton Haxhi – Bëhet fjalë për persona të shpallur në listën e OKB-së. Ministria e Jashtme është institucioni që e merr këtë listë, pra është institucion përgjegjës, që komunikon me OKB-në edhe për futjen në listë të personave që vijnë nga Shqipëria.

Ermonela Felaj – Në fakt, jam e qartë për përgjigjen, sepse kam parasysh, edhe nga procedurat e ndjekura në raste të ngjashme nga Këshilli i Ministrave, që lista e personave të

shpallur terroristë vinte gjithmonë nga Ministria e Jashtme, sepse institucioni që na përfaqëson te Kombet e Bashkuara është pikërisht kjo ministri.

Elona Gjebrea – Dakord.

Atëherë, mund të shtohet një pikë, ku të thuhet: “Këto dy struktura kanë detyrimin të njoftojnë Ministrinë e Punëve të Brendshme”, sepse kur vjen puna te monitorimi dhe situata të tjera pas kësaj, është përgjegjëse Ministria e Punëve të Brendshme. Mund të shtohet diçka.

Si mund të rregullohet kjo?

Ermonela Felaj – Neni 18 i ligjit aktual thotë: “Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme apo ministri të Financave, vendos miratimin, ndryshimin ose revokimin e listës së personave të shpallur, për të cilët zbatohen masat kundër financimit të terrorizimit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe u komunikohet organeve përgjegjëse, të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji dhe botohet në Fletoren Zyrtare.”

Elona Gjebrea – Dakord, është tek “organet përgjegjëse”.

Ermonela Felaj – Njoftimi është. Pra, nuk ndryshon pika 2, por vetëm pika 4...

Elona Gjebrea – Në rregull. Përderisa thuhet “organet përgjegjëse”, është e saktë.

Ermonela Felaj –...ku shtohet pika 4/1 dhe thuhet: “Kërkesa për shpalljet pranë strukturave përkatëse në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dërgohet në rastet kur besohet se janë mbledhur prova të mjaftueshme për mbështetjen e kësaj shpalljeje. Kërkesat e bëra në përputhje me këtë pikë, duhet të bëhen pa njoftim paraprak të personit apo subjektit përkatës.”

Nëse nuk ka pyetje të tjera, kush është dakord me nenin 8 të projektligjit?

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 9, i cili bën ndryshimin te neni 21 i ligjit aktual. Neni 21 i ligjit aktual titullohet “Verifikimi i identitetit, fondeve dhe pasurive të tjera”. Pra, këtu ndryshimi është që afatet ngushtohen dhe veprimi duhet të ndodhë menjëherë ose në një afat të shkurtër.

Atëherë, kush është dakord me nenin 9?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 9.

Kalojmë te neni 10, i cili ndryshon nenin 23 të ligjit aktual, që ka të bëjë me shpenzimet e lejuara nga fondet dhe pasuritë e tjera. Është rasti kur ministri i Financave autorizon pagesa nga fondet dhe pasuritë e bllokuara, gjithmonë për nevojat e jetesës, nevojat familjare apo ato mjekësore, që i paraqiten personit të shpallur terrorist, ndaj të cilit aplikohen masa kundër

financimit të terrorizimit. Pra, është një rast le të themi i jashtëzakonshëm, në kuptimin që nuk ndodh gjithmonë.

Pika që do të shtohet këtu do të jetë: “Autorizimi i ministrit për shpenzimet e lejuara do të kryhet pasi të jenë realizuar procedurat dhe kërkesat përkatëse, të vendosura nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara”. Pra, nuk do të jetë një veprim që e vendos në diskrecion të plotë ministri, në rast se ai çmon për të përballur shpenzimet e jetës apo ato mjekësore, por bëhet fjalë për disa shpenzime të natyrës vetjake të personit të shpallur, që ai mund t’i disponojë drejtpërsëdrejti, por pasi të jenë plotësuar kushtet që vendos Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Besoj se ndryshimi këtu reflekton detyrime ndërkombëtare dhe nuk ka vend që ne ta diskutojmë më tej.

Atëherë, kush është dakord me nenin 10 të projektit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 11, i cili bën disa ndryshime të nenit 25 të ligjit aktual “Ndryshimi dhe revokimi i vendimit për personat e shpallur”. Pra, persona që janë shpallur në listë mund edhe të revokohen nga ajo listë ose të pësojnë ndryshime lidhur me to.

Fjalën e ka zonja Gjebrea, relatorja e projektit.

Elona Gjebrea – Në pikën 6 thuhet: “Kur hiqet masa e sekuestros ndaj fondeve dhe pasurive të tjera, zotëruesi i pasurisë ka të drejtë të kërkojë frutat e pasurisë...”. A përdoret termi “të kërkojë frutat e pasurisë”?

Ermonela Felaj – Është te ligji ekzistues, apo jo?

Elona Gjebrea – Po , është pika 6 e nenit 25 të ligjit ekzistues.

Ermonela Felaj – Ajo pikë nuk ndryshohet.

Elona Gjebrea – E di që nuk ndryshon, por bëra thjesht një pyetje.

Ermonela Felaj – Në pikën 6 të nenit 25 të ligjit ekzistues thuhet: Kur hiqet masa e sekuestros ndaj fondeve dhe pasurive të tjera, zotëruesi i pasurisë ka të drejtë të kërkojë frutat e pasurisë, të realizuara gjatë administrimit”. Pyetja, që bëri zonja Gjebrea, është e drejtë, pavarësisht se nuk mund ta ndryshojmë dot këtë pikë. Pra, a përdoret drejtë termi “frutat e pasurisë” apo duhet të jetë “frytet e pasurisë”?

Elton Haxhi – Frytet e pasurisë është një koncept që i takon pronarit të pasurisë të gëzojë të drejtën për disponimin dhe të gëzojë edhe frytet e pasurisë. Në këtë kuptim është përdorur, dhe kjo është një terminologji e zakonshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Normalisht, fjala duhej të ishte “frytet” , sepse është terminologji juridike. Nëse ka një depozitë me afat që ka prodhuar interes, atëherë ky interes është fryti e saj. Unë besoj se kjo gjë është e qartë. Pra, mund të ndryshohet fjala “frutat” dhe të bëhet “frytet”.

Ermonela Felaj – Atëherë, e marrim si sugjerim, pavarësisht se ajo përkthehet drejtpërsëdrejti nga gjuha latine.

Pra, edhe në pikën 6 të nenit 25 të ligjit aktual, tek i cili është ndërhyrë me nenin 11, të korrigjohet fjala “frutat” me fjalën “frytet”.

Kush është dakord me këtë sugjerim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 12 “Hyrja në fuqi”.

Kush është dakord me nenin 12? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar””.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.06.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nën për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Eljo Hysko, Luan Duzha, Lefter Maliqi , Anduel Xhindi, Myslim Murrizi, Antoneta Dhima, Ylli Shehu, Edmond Rrushi, Elona Gjebra, Xhemal Qefalia, Spartak Braho, Adnor Shemeti dhe Arben Elezi

Mungojnë:

Elena Xhina, Paulin Sterkaj, Luan Harusha dhe Alban Zeneli.

Të ftuar:

Elton Haxhi - Zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Artur Kala - Kryeadministrator i AAPSK-ut

Elvis Koçi - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Parandalimit dhe Pastrimit të Parave

Agim Muslia - Drejtor i Drejtorisë së Përputhshmërisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave

Ermonela Felaj – Kalojmë në shqyrtimin nen për nen të projektligjit të fundit për këtë mbledhje “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar”. Në fakt, ligji ka ardhur dhe ne do ta diskutojmë, po kështu titullohet sërish.

Ju lutem, a mund ta kemi sërish tabelën, sepse kjo është tabela e tretë, me të cilën duhet të punojmë.

Atëherë, kemi nenin 1 të projektligjit. Ju lutem, shikoni kolonën e dytë, sepse këto janë ndryshimet e propozuara. Ndërkohë, komentet e vendosura në kolonën e tretë, janë ato që na vijnë nga Komisioni i Ekonomisë, gjithmonë për të ndihmuar debatin nen për nen në komisionin tonë. Pra, ne nuk vendosim mbi ato komente.

Propozohet që neni i parë i ligjit të ndryshohet. Në fakt, janë disa ndryshime që ndodhin. Pika që diskutuam dje, ishte ajo që lidhej me përkufizimin e personave të ekspozuar politikisht. Sikundër na u dha përgjigja dje, por edhe siç do ta shohim të shkruar në ligj, rrethi i personave të ekspozuar politikisht është i përkufizuar, por është i përkufizuar në ligjin që bën fjalë për deklarin e pasurive dhe konfliktin e interesit.

Pra, atje dihet se kush përfshihet, dhe besoj se jemi në dijeni të kësaj, sepse jemi subjekt që deklarojmë te inspektorati, e natyrisht, të gjithë personat e lidhur me ne, edhe ata plotësojnë deklaratën bashkëlidhur.

Kush ka vërejtje për nenin 1 të projektligjit?

Nuk ka pyetje, nuk ka vërejtje.

Kush është dakord me nenin 1 të projektligjit?

Po. Faleminderit! Kundër e abstenime nuk ka.

Miratohet neni 1 i projektligjit.

Në fakt, janë disa pika të ndryshuara në këtë nen.

Kalojmë te neni 2 i projektligjit, i cili ndryshon nenin 3 të ligjit aktual, lidhur me subjektet që u nënshtrohen këtij ligji, pra ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

Në fakt, desha të bëja një pyetje: pse hiqet fjala “noterët” dhe zëvendësohet me termin e përgjithshëm: “përfaqësues të tjerë ligjorë”?

Avokati është përfaqësues ligjor. Të tjerë mund të bëhen përfaqësues me prokurë. Nuk është se noteri është përfaqësues ligjor. Ai është një person në shërbim publik, i cili konfirmon vullnetin e palës apo personit që paraqitet. Nuk është përfaqësues.

A mund të kemi një përgjigje në lidhje me këtë?

Po, zoti Koçi.

Elvis Koci – Faleminderit për fjalën!

Propozimi origjinal ishte që të shtoheshin pikat 1 dhe 2 të germës ‘gj’, që në Komisionin e Ekonomisë u propozua të shtoheshin, por t’u bashkëngjiteshin pjesës më lart të ligjit. Nuk ka pse profesionet të jenë veç, le të renditen njëra pas tjetrës, me presje. Për ne nuk përbën ndonjë ndryshim thelbësor, për sa kohë që përcaktohen. Pra, fjala “noterët” është aty. Nuk hiqen noterët, por thjesht bashkohen në një pikë. Është propozim i Komisionit të Ekonomisë.

Ermonela Felaj – Po pse?

Elvis Koci – Ndoshta thjeshtim në shkrim.

Ermonela Felaj – Po pse duhet ta ndani shkronjën në disa nënshkronja tani: ‘gj 1’, ‘gj 2’, kur ju i keni këto të shkronja ‘gj’ e ligjit aktual. Keni avokatët, keni noterët, keni përfaqësuesit e tjerë ligjorë, keni ekspertët kontabël të autorizuar, të pavarur, keni kontabilistët e miratuar, të pavarur, keni zyrat e konsulencës financiare dhe profesionet e rregulluara, të cilat ofrojnë shërbime konsulencë dhe përgatisin ose kryejnë transaksione. Pra, kush mungon, që ju nuk e keni të ‘gj’-ja, që duhet ta ndryshoni ose ta ndani germën ‘gj’? Pra, cila është arsyeja?

Po, zoti Haxhi!

Elton Haxhi – Në radhë të parë, ndryshimi konsiston në disa terminologji, të cilat ligjet e tjera i kanë ndryshuar. Për shembull, ekspertët kontabël të autorizuar sipas ligjit të ri “Për auditimin” janë përkufizuar si auditues ligjorë. Ndryshimet kanë të bëjnë me ndryshimet e disa profesioneve të lira, si pasojë e ligjit respektiv. Pastaj është bërë ndarja në disa pika. Propozimi i Komisionit të Ekonomisë, ka qenë që t’i bashkojmë përsëri në një pikë. Ne kemi rënë dakord. Pra, do të qëndrojnë vetëm ndryshimet në përkufizimet e profesioneve të lira.

Ermonela Felaj - Ka sens. Dua t’i ftoj kolegët që të njëjtën gjë të propozojmë edhe ne. Pavarësisht se mund të kenë ndryshuar termat për shkak të ligjeve të tjera, të institucioneve të tjera, të gjitha termat e ndryshuara të reflektohen si ndryshim në germën “gj” të nenit që ju keni sjellë si pjesë të projektit tuaj.

Me këtë ndërhyrje të natyrës së teknikës legislative, kush është dakord me nenin 2 të projektit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Neni 3 i projektit, shton një nen 3/1 të “Detyrimet e organizimeve ligjore”. A ka ndonjë pyetje? Nuk ka. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4, bëhen disa ndryshime të vogla në nenin ekzistues, që është neni 4 “Rastet kur kërkohet vigjilenca e duhur”. Ka pyetje? Nuk ka. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5 bën ndryshime në nenin 4/1 të ligjit ekzistues “Masat e vigjilencës së duhur”. Ka pyetje? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 5 të projektit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6 bën fjalë për “Vigjilencën e thjeshtuar”. Ka pyetje ose ndonjë ndërhyrje nga përfaqësuesit e Ministrisë së Financave? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 6 të projektit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7, i cili bën një ndryshim të nenit 5 të ligjit aktual “Dokumentacioni i kërkuar për identifikimin e klientit”. Për identifikimin dhe verifikimin e identitetit të klientit subjektet duhet të regjistrohen dhe të mbajnë të dhënat si më poshtë. Përveç gjeneraliteteve të tij, duhet të mbajnë edhe të dhëna që lidhen me numrin e dokumentit të identifikimit, me numrin personal për shtetas të Republikës së Shqipërisë, si edhe atë të barasvlershëm për shtetasit e huaj, autoritetin që e ka lëshuar dhe të gjitha ndryshimet që ai ka pësuar në çastin kur ndodh transaksioni. Hollësira të tjera vijnë edhe për personat fizikë që ushtrojnë veprimtari fitimprurëse. Pra, me këtë ndryshim kërkohen që të detajohen të dhënat e personave. Kush është dakord me nenin 7 të projektit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8, i cili ndryshon nenin 6 të ligjit aktual “Zhvillimet teknologjike dhe palët e treta”. Jo të gjitha nenet kanë lidhje me përmbajtjen e punës specifike që ne kemi në këtë komision. Kush është dakord me nenin 8 të projektit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9. Titulli është ai që ka qenë. Kush është dakord me nenin 9, që ndryshon nenin 6 të ligjit aktual? Duhet të bëhet një korrigjim tek titulli, duke u përshkruar drejt: “Mbështetja në palët e treta”. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10, që ndryshon nenin 7 të ligjit aktual “Vigjilenca e zgjeruar ndaj klientit”. Ka ndryshime në tri pika të paktën.

Kush është dakord me nenin 10? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 11, i cili ndryshon kategorinë e klientëve ndaj të cilëve zbatohet vigjilenca e zgjeruar, duke ndryshuar titullin: “Vigjilenca e zgjeruar nuk zbatohet thjesht ndaj disa klientëve, por edhe ndaj transaksioneve të atyre klientëve ...” dhe vazhdon më tej.

Kush është dakord me nenin 11 që ndryshon nenin 8 të ligjit aktual? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 12, i cili ndryshon nenin 9 të ligjit aktual, pikërisht atë që sapo ju thashë, kategoritë e transaksioneve dhe të marrëdhënieve të biznesit, ndaj të cilave zbatohet vigjilenca e zgjeruar.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 13 i projektit, i cili ndryshon nenin 10 “Detyrimet për shërbimin e transferimit të parave ose të vlerave”.

Kush është dakord me nenin 13? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 14, i cili ndryshon nenin 10, duke i shtuar nenin 10/1, që reflektohet me një përmbajtje të re: “Bllokimi i përkohshëm si rrjedhojë e detyrimeve ndërkombëtare”.

Kush është dakord me nenin 14 të projektit? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 14.

Neni 15, ndryshon nenin 11 të ligjit aktual “Masat parandaluese të ndërmarra nga subjekte”.

Kush është dakord me nenin 15? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Ligji është transpozim edhe i direktivave europiane, kështu që në Komisionin e Integritetit është parë edhe për përputhjen në raport me aty ku ligji është menduar të merret si model.

Miratohet neni 15.

Kalojmë te neni 16, që ndryshon nenin 12 të ligjit aktual “Raportimi tek autoriteti përgjegjës”. Ka një ndryshim të vogël në pikën 2, ku thuhet: “Subjekti, të cilit i kërkohet nga klienti të kryejë një transaksion ka dyshime se transaksioni mund të përfshijë pastrim të produkteve të veprës penale, financim të terrorizmit apo fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale ai duhet të mos e kryejë transaksionin, ta raportojë menjëherë rastin te autoriteti përgjegjës dhe të kërkojë udhëzime nëse duhet ta kryejë apo jo transaksionin”.

Te kjo pikë bëhet një ndryshim, hiqet fjala “të cilit i kërkohet nga klienti të kryejë një transaksion”. Pra, direkt subjekti, nëse ka dyshime për një transaksion, raporton edhe pa qenë kërkesa nga një person i tretë.

Kush është dakord me nenin 16? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 16.

Kalojmë te neni 17, që ndryshon nenin 14 të ligjit ekzistues “Përjashtimi nga përgjegjësia ligjore për raportim pranë autoritetit përgjegjës”. Bëhet fjalë për rastin kur subjektet ose autoritetet mbikëqyrëse, drejtuesve, zyrtarëve ose punonjësve të tyre u japin në mirëbesim informacione ato përjashtohen nga përgjegjësia për shkak të mirëbesimit”.

Këtu besoj se ka vetëm një saktësim të fjalëve “nxjerrja e sekretit profesional ose bankar” zëvendësohet “me nxjerrjen e sekretit profesional dhe/ose bankar, që të vendosen me kontratë apo me çfarëdo dispozite ligjore, rregullative apo administrative”.

Kam përshtypjen se e gjithë kjo ju ndihmon të referoni më mirë se çfarë përbën sekret, apo jo?

Po, zoti Koçi.

Elvis Koçi – Kjo dispozitë është bërë për të lehtësuar dhe për të sqaruar më mirë subjektet raportuese. Pra, ata janë të çliruar nga barra e sekretit bankar apo profesional, për sa kohë që raportojnë në një agjenci si jona, që trajton pikërisht informacione sekrete dhe kjo nuk përbën shkelje të dispozitave ligjore apo edhe të kontratave që ata mund të kenë për të ruajtur sekretin.

Pra, i qetëson ose zgjidh nga ana ligjore merakun që palët janë në shkelje ose jo dhe i shkarkon nga shkelja.

Ermonela Felaj - Është e qartë. Unë e kam fjalën për pjesën e dytë që ju keni shtuar, pra fjalëve “nxjerrjen e sekretit profesional ose bankar” ju i keni shtuar edhe shprehjen “të vendosur me kontratë ose me çfarëdo dispozite ligjore rregullative ose administrative”.

Jam dakord me këtë gjë, sepse i orienton më mirë subjektet që kanë detyrim raportimin për atë që përbën sekret dhe që natyrisht ata duhet ta mbrojnë. E gjithë pjesa tjetër pastaj janë të përjashtuar nga përgjegjësia.

Agim Myslija-Nuk ka asnjë kontratë që mund ta ndalojë subjektin që të raportojë te ne përderisa ai është i shkarkuar nga përgjegjësia sipas atyre kontratave.

Ermonela Felaj - A keni ndonjë pyetje tjetër?

Kush është dakord me nenin 17? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 18 që ndryshon nenin 16 të ligjit “Detyrimet për ruajtjen e të dhënave”.

Antoneta Dhima - Te pika 2: “Dokumentacioni për transaksionet financiare” zëvendësohet me “Dokumentacionin për transaksionet”. Pse hiqet financiare? Çfarë problemi ka?

Agim Myslia – Sepse ky ligj i shtrin efektet e veta edhe te subjekte që nuk bëjnë transaksione financiare, pra janë profesionet e lira. Në vlerësimin e fundit që i është bërë vendit tonë është konsideruar që termi “transaksione financiare” mund të interpretohet si kufizues në zbatimin e ligjit prandaj kjo është arsyeja.

Ermonela Felaj - Faleminderit për sqarimin!

Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet!

Kalojmë në nenin 19 që ndryshon nenin 70, për raportimin e organeve doganore. Është momenti të kujtojmë që është një pjesë e atyre diskutimeve që ne patëm gjatë ditës së djeshme në rastin e raportimeve, që mbahen pranë pikave të kalimeve doganore.

A keni ndonjë pyetje, ose sqarim që shihet si i nevojshëm?

Pra, sipas ligjit aktual çdo person shqiptar ose i huaj që hyn ose largohet nga territori shqiptar është i detyruar që të deklarojë shumat në të holla dhe çdo lloj instrumenti tjetër të negociueshëm ku hyjnë metalet dhe gurët çmuar, objektet antike duke filluar nga shuma 1 milion lekë ose kundërvlera e saj në monedha të tjera.

Elona Gjebrea- Çfarë nënkuptoni me fjalën metale, sepse është shumë e përgjithshme?

Agim Myslia- Metalet e çmuara mund të jetë ari, argjendi, ka edhe metale të tjera që janë të çmuara.

Ermonela Felaj - Kush është dakord me nenin 19? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20 që bën fjalë për deklaratimet në kufi dhe këto janë deklarime që ne duhen bërë nga të gjithë para se të dalim ose të hyjmë në territorin shqiptar.

Janë bërë disa ndryshime, në fakt, dhe janë bërë edhe disa rekomandime nga Komisioni i Ekonomisë. Nëse do të doni t’i shikoni po rezervojmë një minutë kohë.

Ne e thamë që është rritur kufiri, nuk është më 10 milionë. Pra, 1 milion lekë është bërë 10 mijë euro, për t’u përshtatur me vendet e tjera.

A mund të na ndihmoni, cili ka qenë propozimi i Komisionit të Ekonomisë për të bërë edhe ne një arsyetim sa më të mbështetur?

Po, zoti Koçi.

Elvis Koçi – Komisioni i Ekonomisë kërkoi të specifikohet që bëhet fjalë për ekuivalentin në lekë të shumës 10 mijë euro, apo të kartëmonedhave të tjera, ndërkohë që ramë dakord për rritjen e limitit për ta përafëruar me kufitarët.

Kishte një diskutim rreth hyrjes në fuqi të datës 1 janar 2020, që kemi propozuar, nëse mund të hynte në fuqi më herët, por, duke qenë se është hera e parë që në legjislacionin shqiptar futet koncepti i gjobave administrative, ne do të donim të bënim një fushatë mediatike për njohjen e subjekteve para se të fillojmë të aplikojmë gjobat, ndaj edhe e kemi shtyrë për këtë datë.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

E diskutuam edhe gjatë ditës së djeshme dhe është e vërtetë që mundet të mos deklaroj, ndërkohë që ke detyrimin e deklarimit, kur ke të holla mbi limitin që lejon ligji. Është hera e parë që do të vendosen masa ndëshkimore dhe sanksione administrative, që shkojnë në proporcion me sasinë e të hollave që ti ke në limit.

Mendoj se është më se e arsyeshme ajo që sapo thatë, që na nevojitet të bëjmë një fushatë, sepse koha e zakonshme e hyrjes në fuqi të një ligji jo gjithmonë mjafton, që shtetasit të marrin dijeni për përmbajtjen e ligjit apo edhe për ndryshimet e ndodhura në këtë ligj.

Kështu që do t'i ftoja kolegët ta votojmë në variantin që është propozuar nga qeveria.

Kush është dakord me nenin 20? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 21, i cili bën disa ndryshime po te neni 21 i ligjit aktual, lidhur me organizimin e autoritetit përgjegjës, pra mënyrën se si organizohet Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 22, që shton një nen tjetër pas nenit 21, neni 21/1, që bën fjalë për detyrimet e subjekteve të ligjit dhe organeve publike për të dhënë përgjigje ndaj kërkesave për informacion të autoritetit përgjegjës. Edhe ky më duket një nen që e ndihmon punën e drejtorisë, sa kohë që puna e saj bazohet tek administrimi në kohë të shpejtë i analizës së informacionit, për t'ia dedikuar më pas të gjithë deduksionet organeve përkatëse ligjzbatuese, policisë apo prokurorisë.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 23, që ndryshon nenin 22, që lidhet me detyrat dhe funksionet që ka Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, si njësi e inteligjencës financiare në vend.

Për shkak të ndryshimeve që ka pësuar ligji në vetvete, kuptohet që edhe detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave duhet të revizionohen dhe këtë e paraqet neni 23 i projektit.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

I ftoj kolegët të reflektojnë edhe termat e reja që kanë sjellë edhe ligjet e reformës në drejtësi, sepse një pjesë e mirë e punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave do të lidhet edhe me SPAK-un, sapo ai të konstituohet.

Kalojmë në nenin 24, që ndryshon nenin 23, që bën fjalë për detyrat e Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave. Ky Komitet drejtohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje ministrin e Financave dhe të Ekonomisë, ministrin e Europës dhe Punët e Jashtme, ministrin e Mbrojtjes, ministrin e Brendshëm, ministrin e Drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm, drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Drejtorin e Shërbimit Informativ të Shtetit, Inspektorin e Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Keni ndonjë sugjerim për këtë nen, kolegë?

Mendoni që pjesë e këtij Komiteti duhet të jetë edhe ndonjë subjekt tjetër, apo është i mjaftueshëm rrethi i personave që janë përfshirë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Te pika 2 nevojitet një përshtatje. Të themi edhe këtu “ministri përgjegjës për Ekonominë dhe Financat”, sepse ne i kemi bërë “ministri përgjegjës për Europën dhe Punët e Jashtme”, “ministri përgjegjës për Mbrojtjen, ministri përgjegjës”... Pra, siç e kemi reflektuar tek të gjitha nenet e tjera.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Ndonjë sugjerim tjetër nga kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Hoxha, keni ndonjë sugjerim për përbërjen e komitetit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është se ndryshon diçka tjetër, thjesht shtohen figurat e reja që ka sjellë reforma në drejtësi, asgjë tjetër. Pra, funksionon e njëjta gjë.

Kush është dakord me nenin 24 të projektligjit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe ky nen, me sugjerimin, që, në fakt, me të drejtë, ka bërë Komisioni i Ekonomisë për përshtatjen e termave, sa herë flasim për pozicionet e ministrave, që, natyrisht, si emërtime janë edhe të ndryshueshme. Prandaj përdoren fjalët “ministri përgjegjës për fushën përkatëse”.

Vijojmë me nenin 25, i cili sjell ndryshime në nenin 24 të ligjit aktual për funksionet e autoriteteve mbikëqyrëse. Me sa shoh, ka disa sistemime, por jo ndërhyrje të natyrës thelbësore.

Kush është dakord me nenin 25? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 26, i cili, në fakt, bën fjalë për kundërvajtjet administrative dhe për masat e gjobave, që do të aplikohen në rastet kur janë ezauruar, le të themi, masa të tjera administrative që duken më të lehta, siç është rasti i paralajmërimeve, urdhrave që e detyrojnë subjektin të ndalojë një sjellje të caktuar (praktikë pune ose biznesi), urdhrave për të pezulluar përkohësisht ose për të zëvendësuar drejtuesit e strukturave përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, pastaj vjen gjoba, si nivel i parafundit, dhe niveli i fundit, që është shpallja publike e kundërvajtjesit dhe natyrës së kundërvajtjes.

Do të tërhiqja vëmendjen e kolegëve të masat e gjobës. Në fakt, unë pata rastin edhe gjatë ditës së djeshme, në mënyrë informale, ta bisedoja me drejtorin që më shumë se sa masa e gjobës, marzhi nga minimumi të maksimumi duket shumë i lartë. I gjithë merakut është që marzhe me diferencë kaq të madhe nga njëri-tjetri mund të përbëjnë shkak për abuzim.

Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Te pika 1 e nenit, e kam për ju, thuhet: “Për shkeljet e kryera nga subjektet, kur nuk përbëjnë vepër penale, autoriteti përgjegjës vendos një ose disa masa ndëshkimore”. Çfarë do të thotë një ose disa?

Ermonela Felaj – Besoj se pyetja e zotit Braho është me vend, sepse, siç është shkruar, presupozohet që këto masa të vihen edhe të gjitha njëherësh, ndërkohë që nuk mendoj se ideja ka qenë që të vendosen të gjitha njëherësh.

Elvis Koçi – Jo, por mund të vendosen disa.

Domethënë, nëse një subjekt nuk ka raportuar diçka të rëndësishme, atëherë personi përgjegjës për raportimin të subjekti përkatës duhet pezulluar nga detyra dhe, paralelisht me këtë, duhet ndërmarrë edhe një masë tjetër. Në varësi të asaj që nuk ka deklaruar dhe çfarë pasojash ka sjellë, mund të vendoset edhe gjoba. Pra, mund të ndërmerren disa masa njëherësh, siç mund të jenë: urdhri i pezullimit, urdhri i ndalimit (të ndalë sjelljen e ndaluar) dhe gjoba. Mund të jenë të tria bashkë, për shembull, germet “b”, “c” dhe “ç”.

(Deputeti Braho ndërhyr pa mikrofon.)

(Diskutime në sallë)

Ermonela Felaj – Zoti Koçi, duke iu bashkuar ndërhyrjes së zotit Braho, do të isha për riformulimin e këtij neni dhe, përpara se të përcaktonim cilat janë masat që do të merren, të përcaktojmë në mënyrë të përgjithshme, e para, që merren masa ndëshkimore, si gjobat ose jo gjobat.

E dyta, këto masa ndëshkimore merren sipas disa kriterëve, të cilat duhen saktësuar që më pas të vijmë te masat konkrete.

Jo, duke vënë që në fillim masat dhe marzhet e gjobave pa vajtur te kriteret, se edhe për atë që e zbaton, edhe për atë që e lexon, është e rëndësishme të kuptojmë që gjobat ose masat nuk merren *a priori*, por pas një analize paraprake, ku çmohet fuqia financiare e personit, përfitimet që ka ai nga shkelja, humbjet që mund të ketë shkaktuar te palët e treta, pra të gjitha këto kriterë që ju i keni vënë. Nëse ne e ndajmë nenin, duke vënë në fillim pjesën e përgjithshme dhe pastaj të vijmë te masat konkrete, besoj se do të ishim edhe më të kuptueshëm qoftë për ata që do t’i zbatojnë këto masa, qoftë për ata që do t’i pësojnë këto masa. Pra, unë mendoj se është i nevojshëm një riorganizim brenda nenit, sepse kjo duket edhe nga përgjigja e pyetjeve. Sapo ju pyeti zoti Braho dhe ju thatë: po, mund të jepen disa masa në varësi të 1-2-3 gjërave. Do të ishte mirë që ne t’i paraprinim kësaj dhe të thoshim në fillim kriteret dhe më pas të shkonim te masat.

Elvis Koçi - Neni 26 është i ndarë në 3 pika. Te pika e parë kemi llojin e masave, te pika e dytë kemi listuar kriteret, dhe te pika 3, janë gjobat.

Ermonela Felaj – Atëherë, unë po thosha që direkt pas pikës 1, pa shkuar te germet “a”, “b”, “c” e me radhë, të fusim pikën 2, ku të themi, se për shkeljet e kryera nga subjektet, kur nuk përbëjnë vepër penale, autoriteti përgjegjës vendos disa masa ndëshkimore dhe gjobë. Përcaktimin e llojit të masës së...

Duhet të ndajmë nëse do të përdorim fjalën “ndëshkim” apo do të përdorim fjalën “sanksion”. Përveç kriterëve që ka ligji për kundërvajtjet administrative mbahen parasysh: 1, 2, 3. Më pas të themi, se sanksionet që vendosen, janë këto: ...

Më pas vjen pika 3, e cila të orienton se kur vendoset gjobë. Ky është sugjerimi ynë, të cilin do t’ia çojmë Komisionit të Ligjeve. Të tjerat zgjidhni aty!

Unë bie dakord me të gjithë kolegët, që marzhi i dënimeve brenda masës që ju keni orientuar, duhet të rishikohet dhe të ngushtohet dhe të mos fillojë nga 1 milion lekë të vjetra deri në 60 milionë lekë. Ky marzh është shumë i lartë, duhet ngushtuar. Nuk e di se ku e keni parë këtë masë të përdorur.

Elvis Koçi - Ne jemi kritikuar që masat që parashikojmë mund të mos jenë efektive për subjekte të caktuara, me një fuqi të caktuar ekonomike. Nëse kemi parasysh që në sistemin tonë financiar ka banka që e kanë fitimin vjetor mbi 50 milionë euro në vit, ndërkohë që gjoba maksimale që ne mund të vëmë është vetëm 6 milionë lekë ose 50 mijë euro, kjo është çështje përpjesëtueshmërie. Ne kemi në sistemin tonë shqiptar subjekte aq të mëdha, sa që edhe limiti maksimal i gjobës është i diskutueshëm, ndërkohë që kemi edhe të vogla, sepse kriteri i parë, te pika “a” thotë: “fuqia financiare e personit përgjegjës për shkeljen”.

Për t’iu kthyer mbrapsht pyetjes: pse duhet të vendosen disa masa, të cilat unë i listova, nëse marrim një rast hipotetik që një subjekt po kryen transferta drejt Koresë së Veriut, të cilat mund të përdoren edhe për financimin e teknologjive bërthamore dhe ky subjekt vijon në vazhdimësi t’i kryejë, ne duhet t’ia ndërpresim transfertat, që është pika “b” e masës.

Ndërkohë, nëse kjo është një shkelje kaq e rëndë, patjetër që personi përgjegjës brenda atij subjekti për parandalimin e këtyre sjelljeve, është përgjegjës dhe nuk mund të vazhdojë në atë detyrë.

Është edhe pika “c”, që flet për urdhrin për pezullimin e përkohshëm apo zëvendësimin e drejtuesve të strukturave përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në varësi të dëmit që ka sjellë një sjellje e tillë (unë mora një rast hipotetik), patjetër që duhet vënë edhe pika “ç”, që është gjoba. Pra, në varësi të rastit do të duhet të merren disa masa dhe, në varësi të subjektit dhe se çfarë ka bërë subjekti, mendoj se limiti i sipërm është i vogël, jo i madh. Sigurisht që proporcionaliteti i efekteve që ka sjellë veprimi kundrejt gjobës do të jetë objekt i VKM-ve që do të dalin në zbatim të këtij ligji.

Ermonela Felaj - Po, zoti Murrizi.

Myslim Murrizi- Faleminderit!

Unë mendoj se jo vetëm këtu, por në çdo ligj kjo tolerancë jep shkak për abuzim. Megjithatë, ai që ka në dorë firmën për të ndëshkuar cilindo kundërvajtës dhe ligji i lë hapësirë që të gjobisë 1 milion deri në 60 milionë lekë, këtu është pazari në mes. Unë mendoj që ta sanksionojmë dhe ta bëjmë me një x përqindje të shumës, që ju gjykoni se është transaksion, e cila, në një farë mënyrë, është taksative, 1,2,3,5% e vlerës që kapet nga organet dhe do të transferohet në Kore ose në Kubë. Kjo i jep shkak për abuzim atij që ka firmën, sepse kushdo qoftë do të tundohej. Nga 1 deri në 60 milionë lekë i ka në dorë ai dhe nuk janë pak. Ai është brenda ligjit kur firmos. Prandaj unë mendoj se ky është shkak për abuzim për cilindo, ju apo kushdo tjetër nesër, që është në krye të atij institucioni.

Ermonela Felaj – A ka mendim tjetër? Po, zoti Vorpsi.

Sadi Vorpsi- Jam plotësisht dakord me zotin Murrizi, sepse ajo mund të bëhet shkak për abuzim. Kështu që duhet rregulluar ky nen.

Ermonela Felaj – Qëndrimi i kolegëve, anëtarëve të këtij komisioni, mendoj se është i qartë, që marzhi i dënimit për gjobat e parashikuara duhet riparë, sepse, pavarësisht arsyetimeve që përdori zoti Koçi, ato subjekte janë të futura brenda atij marzhi, që është në diskrecionin e atij që vë gjobën të vlerësojë dhe ky vlerësim duket më shumë subjektiv sesa objektiv, prandaj, ne mendojmë që kjo të rishikohet.

Ndërkohë, shoh që ju e keni lënë në fuqi pikën 10 të nenit aktual, ku thuhet: “Këshilli i Ministrave përcakton me vendim procedurat e konstatimit, të shqyrtimit, propozimit dhe vendosjes së masave administrative nga autoriteti përgjegjës”. Çfarë gjërash të tjera duhet të përcaktojë Këshilli i Ministrave, sepse ju i keni thënë rastet kur merren masa ndëshkimore, kriteret që do të përdorni dhe çfarë gjobash do të vendosni. Çfarë presupozon lënia në fuqi e pikës 10 dhe çfarë duhet të bëjë më shumë Këshilli i Ministrave?

Elvis Koçi – Pikërisht këto detajime më të qarta të proporcionalitetit të gjobës me dëmin apo me rëndësinë e veprimtarisë së gabuar do të jenë objekt i sqarimit me VKM. Me VKM do të përcaktohet që të vendosim disa tavane të ndërmjetme që përtej një tavani të caktuar të evitojmë abuzimin, por nuk mund t’i listojmë të gjitha në ligj. Ne kemi vënë limitin minimal e maksimal dhe kemi listuar kriteret, por detajimet...

Ermonela Felaj – E kuptoj, por na duhet një fjali që t’i lidhim këto dy nevoja, duke thënë: “Detaje që lidhen me mënyrën e aplikimit të gjobave dhe shmangies së diferencave të larta midis minimumit dhe maksimumit do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Kështu që mendoj që pikën 10 ta riformuloni, në mënyrë që t’i shkojë idesë që ju jeni duke paraqitur në komisionin tonë.

Kam një pyetje për pikën 11. Cili i shqyrton, si organ administrativ, këto gjoba?! Ligji e ka thënë: “E drejta për shqyrtim e kundërvajtjeve administrative të parashikuara në këtë nen nuk mund të ushtrohet kur kanë kaluar dy vjet nga çasti i kundërvajtjes administrative”. Në fakt, unë jam penaliste nga formimi, jo civiliste, por nuk më duket se kjo gjë shkon këtu, sepse afatet e parashkrimit nuk janë afate që parashikohen në këtë lloj ligji, ato janë në ligjin e posaçëm, në Kodin e Procedurës Civile ose Kodin e Procedurës Administrative dhe kushdo mund të referohet te ligji bazë. Ne nuk mund të vëmë diçka këtu, që është objekt i një ligji tjetër. Megjithatë, dua të më sqaroni nëse ka një organ administrativ, që përfshihet në momentin e reklamimit të gjobës, apo direkt ai që nuk është dakord me gjobën shkon në Gjykatë Administrative?

Agim Muslia- Zonja kryetare, fillimisht ka një të drejtë ankimimi në Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave për masat administrative të vendosura, sigurisht, kjo më pas mund të ankimohet. Pra, vendimi i marrë nga titullari institucionit mund t’i nënshtrohet ankimimit në gjykatë. Kjo ndodh rregullisht.

Elona Gjebrea – Në qoftë se është kjo, atëherë duhet përcaktuar. Është komitet? Si krijohet ky komitet? Sepse është shumë e përgjithshme të thuhet se kjo ankimohet te ju, por cila është struktura përgjegjëse? A ka një njësi që ngrihet në këtë rast?

Faleminderit!

Agim Muslia - Ka njësi të posaçme, që ngrihet me urdhër të titullarit. Pra, bazuar në propozimet apo në inspektimet, që u bëhen në vend apo në dinstancë subjekteve të ligjit, për shkeljet e konstatuara bëhet propozimi konkret. Kjo njësi e posaçme brenda drejtorisë merr në shqyrtim vlerësimin që është bërë nga akti inspektimit, i jep të drejtën subjektit që të paraqesë argumente shtesë, sipas shkeljeve që janë konstatuar, dhe i bëhet një propozim drejtorit të Përgjithshëm, nëse do të lihet në fuqi masa e propozuar. Kjo është e përcaktuar me VKM.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Në cilën VKM?

Agim Muslia - VKM-ja nr. 871 “Për propozimin e masave administrative”.

Ermonela Felaj – Në rregull, meqenëse ne nuk shquhemi që konsolidojmë legjislacionin, sa herë e ndryshojmë legjislacionin, nuk e bëjmë këtë dhe nuk e bën asnjë institucion, do të ishte e nevojshme që në përmbajtjen e këtij neni ju ta parashikoni në mënyrë të saktë procedurën e ankimit. Pra, gjithsecili që i referohet këtij ligji, të dijë organin ku ankohet, sa afat ka për t’u ankuar dhe, në rast se organi administrativ ku ai ankohet nuk vendos sipas kërkesës së tij, sigurisht që ai ka të drejtë të shkojë në gjykatë dhe të gjitha këto duhet të gjejnë

vend në këtë nen. Ligji vlen për të gjithë dhe jo domosdoshmërisht të gjithë ata që impakton ky ligj duhet të kenë dhe njohuri të vendimeve, që kanë dalë, të akteve nënligjore e të tjera me radhë. Në rastin konkret ju e keni të lehtë, sepse nuk është se po referoni nga ky ligj te një ligj më i lartë, që ne nuk do ta lejonim. Ju po referoni nga ky ligj te një akt nënligjor. Kështu që atë pjesën, që e ka akti nënligjor, mundeni ta vini këtu. Pyetja e fundit që kam për këtë nen: *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rregull, unë bëra konstatimin për pikën 11, por pse e keni ndryshuar afatin nga 2 deri në 5 për parashkrimin të të drejtës për shqyrtimin kundërvajtjes? Ku jeni bazuar për këtë?

Agim Muslia - Sipas rekomandimeve, që janë bërë në raportin e *MONEYVAL-it*, afati 2-vjeçar shpeshherë nuk mund të mbulohet me kapacitetet që ka drejtoria për të kryer inspektime në vend. Ajo që ndodh në praktikë është se rëndomtë ka raste që konstatohen, që e kanë kaluar këtë afat 2-vjeçar për të cilat ne nuk mund të vendosim masë administrative dhe kjo ka qenë arsyeja që është zgjeruar nga 2 në 5. A mund t'ju jap shumë shpejt një shpjegim për çështjen e procedimit administrativ? Në të gjitha njoftimet, që i bëhen subjektit për shkeljen e konstatuar, sigurisht përmendet baza ligjore, që është ligji “Për kundërvajtjet administrative” dhe të gjitha nenet përkatëse për shkallët që ndiqen në gjykatë afatet dhe të drejtat që ka subjekti për ankimim.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Kam përshtypjen që referenca duhet të jetë te ligji “Për kundërvajtjet administrative”. Nuk mund të vendoset thjesht duke u nisur nga realiteti praktik, sepse ai është ligji i posaçëm dhe për rastin në fjalë duhet të aplikohet ai para një ligji të përgjithshëm, por edhe për çështje të kësaj natyre. Besoj se ne i kemi mundësitë që të gjitha këto, që folëm, t’ia sugjerojmë Komisionit të Ligjeve, si komision përgjegjës, të cilit do t’i sugjeronim, që të rishikonte edhe një herë formulimin e këtij neni në tërësi, duke pasur parasysh që më parë të vendosen formulimet e natyrës së përgjithshme për sa u takon sanksioneve dhe më pas ato që janë të veçanta.

Së dyti, të rishikonte masën e marzheve.

Së treti, të siguronte që aplikimi i gjobave të bëhet në përputhje dhe me hollësi, që do të vendosen në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Së katërti, formulimi i këtij neni të parashikonte procedurën e ankimimit, rregullat e ankimimit në organin administrativ dhe të shmangete referenca në ligje të tjera, që janë të posaçme. Natyrisht, duke qenë të tilla, janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjithë.

Atëherë me këto sugjerime, a jeni dakord për nenin 26 të projektit? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 27. Neni 27 ndryshon nenin 28, konkretisht shfuqizon germën “d” të pikës 3. Kush është dakord me këtë ndërhyrje të propozuar? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni i fundit ka të bëjë me hyrjen në fuqi, por ka të bëjë me dy momente, i gjithë ligji hyn në fuqi në afatin e zakonshtëm, me përjashtim të atij detyrimi që thamë ne, që duhet të bëhet i njohur për të gjithë deklaruesit në pikat e kalimit kufitar që, në rast se ata nuk deklarojnë të hollat e mbajtura mbi limitin 10 000 euro, do t’i nënshtrohen masës ndëshkimore me gjobë, e cila është proporcionale në raport me sasinë e të hollave të gjetura mbi limitin. Për këtë pjesë propozohet që ligji të hyjë në fuqi në datën 1 janar të vitit që vjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk është instrument i panjohur, sepse e kemi përdorur edhe te Kodi Doganor, ku një pjesë hyri në fuqi më parë se pjesa tjetër.

Kush është dakord me nenin e hyrjes në fuqi? Faleminderit! Kundër dhe abstenime nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Na duhet edhe një anëtar për të bërë votimin në tërësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk jemi dhjetë anëtarë.

Ndërkohë, sa të na bashkohet kolegu tjetër për të realizuar kuorumin e nevojshëm për votimin në tërësi, zonja Dhima ka një pyetje për ju.

Antoneta Dhima – Cilat janë instrumentet që ju do të përdorni që pikat e nenit 20 të bëhen të ditura për të gjithë?

Agim Muslia – Ne do të bashkëpunojmë me doganat dhe Policinë Kufitare për publikimin e ndryshimeve të reja në pikat e kalimit kufitar, të cilat të qëndrojnë për një kohë relativisht të gjatë në mënyrë që të mundësojnë njohjen sa më shumë të tyre. Gjithashtu, në bashkëpunim me këto institucione do të shikojmë sa e nevojshme mund të jetë ndonjë fushatë informimi në media.

Ermonela Felaj – Kush është dakord me votimin në tërësi të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar”? Faleminderit! Kundër dhe abstenim nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit kolegëve dhe përfaqësuesve të ministrisë për durimin që patën gjatë ditës së sotme!

Sipas fjalës që lamë pak më parë, ndërkohë që kjo mbledhje mbyllet këtu, ju lutem të rrinë vetëm anëtarët e komisionit që kanë certifikatë sigurie për të dëgjuar përgjigjen për pyetjen e zotit Murrizi, meqenëse ajo është përgjigje konfidenciale.

MBYLLET MBLEDHJA